



PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Supervizion punimesh per objektin: “Përmirësim i efencës së energjisë dhe implementim të paneleve fotovoltaike për shoqërinë Durrës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
71247000-1“Mbikëqyrja e punës së ndërtimit”

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,794,222.690 (tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzet e dy pikë gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i Financimit: Vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për shpenzimet operative për vitet 2026-2028.

Financimi do të bëhet për një periudhë 3 vjeçare përkatësisht vitet 2026-2027-2028

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar me VKM Nr.498, datë 1.8.2024, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Afati i realizimit është 12 muaj

Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet.

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: “Supervizion punimesh per objektin: “Përmirësim i efencës së energjisë dhe implementim të paneleve fotovoltaike për shoqërinë Durrës”.

"Tabela shoqëruese e tarifave -", GRUPI TARIFOR III

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) ¹Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto x

Çmimi pikët 50

Propozimi Teknik pikët 50

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja për Shërbime të Ngjashme të Konsulentit [0-10]

Nënkriteret

i/a Përvoja për shërbime të ngjashme

40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Certifikata e standardeve të cilësisë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-30]

Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia	[20-30%]
ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit	[30-40%]
ii.c. Organizimi i Stafit	[20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret..

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Metodologjia që ndiqet për realizimin e punimeve synon të garantojë cilësinë e ndërtimit të objektit, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve, kontrollin sasior të volumeve të preventivit, si dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo organizative që dalin gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Metodologjia do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin e projektit. Metodologjia prezanton gjithashtu detyrat dhe strukturën organizative të

grupit të zbatimit të punimeve. Përmban menaxhimin dhe përgjegjësitë kryesore të grupit të zbatimit të projektit.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- | | |
|------------------------------------|-----------|
| a- Kualifikim i përgjithshëm | [5-20%] |
| b- Eksperienca në fushën përkatëse | [30-80 %] |

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. te ndryshuar me VKM Nr. Nr. 498, datë 1.8.2024

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

- Sipas kriterëve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024, nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës (vlera e fondit limit).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024. Lloji i procedurës është ”E Hapur e Thjeshtuar

Shërbime”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit E hapur e Thjeshtuar Shërbime si dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Shenim: Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar, Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për mbikqyrje të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr.943 datë 28.12.2016”, me kategoritë si më poshtë:

- NP- 1** Punime gjurmimi në tokë
- NP- 2** Ndertime civile dhe industriale
- NP- 3** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje
- NP- 7** Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
- NP-11** Ndërtimi i nënstacioneve, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë dhe të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- NP-12** Punime të inxhinierisë së mjedisit
- NS-4** Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik, dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- NS-12** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS-14** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni etj
- NS-18** Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024, si dhe vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr.943 datë 28.12.2016”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqënese kemi të bëjmë me Mbikqyrjen e punimeve në zbatim argumentojmë se Kategoritë e mësipërme janë përcaktuar në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit për Objektivin: **Supervizion punimesh per objektin: Permiresim i eficences se energjise dhe implementim te paneleve fotovoltaike per shoqërinë Durrës**”. Gjithashtu këto kategori license bazohen edhe në projektin dhe Specifikimet teknike të punimeve të zbatimit për këtë objekt.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor si drejtues teknik në licensë të kompanisë, si më poshtë:

- Drejtuesin e mbikëqyrjes se punimeve duhet të jetë **Inxhinier Ndërtimi** me liçencë profesionale përkatëse si drejtues teknik në licensë, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikaten e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondencën me SHRUKD sh.a, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
- Inxhinieri për punimet hidroteknike që duhet të jetë **Inxhinier Hidroteknik** me liçencë profesionale përkatëse, si drejtues teknik në kompani me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
- Inxhinieri për punimet mekanike që duhet të jetë **Inxhinier Mekanik** me liçencë profesionale përkatëse, si drejtues teknik në kompani me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.
- Inxhinier për punimet elektrike i pajisur me liçensën përkatëse që duhet të jetë **Inxhinier Elektrik** si drejtues teknik në licensën e kompanisë me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit
- Inxhinier për punimet elektrike i pajisur me liçensën përkatëse që duhet të jetë **Inxhinier Elektronik** si drejtues teknik në licensën e kompanisë me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve të teknologjisë ë informacionit dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit
- Inxhinieri për matjet topografike që duhet të jetë **Inxhinier Topograf** me liçence profesionale përkatëse si drejtues teknik në licensën e kompanisë, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton pozicionimet dhe akset e objekteve si dhe volumet e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

Për secilin pjestar te stafit kryesor te mesiperm duhet te paraqese:

Kontrate pune e vlefshme

Licencat profesionale për mbikqyrje të kompanisë ky të përfshihen si drejtues teknik inxhinierët e mësipërm.

***** Në këtë rasti stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

2.3.3/1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të ketë në stafin e tij:

-Specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose me marrëdhënie kontraktore/kontratë (të noterizuar) me qëllim ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

-Punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

-Punonjës i pajisur me certifikatë "Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësive sipas SSH EN ISO 9001:2015" ose ekuivalent e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar me VKM Nr.498, datë 1.8.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Grupi hartimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, gjithashtu argumentojmë se zgjedhja e stafit të mbikqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivin e objektit : " Supervizion punimesh për objektin: Permiresim i eficences se energjise dhe implementim te paneleve fotovoltaike per shoqërinë Durrës"

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 10 persona dhe të pasqyruar në liste pagesat e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si reference datën e hapjes së procedurës.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve te fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së procedurës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar prej **10 punonjësve** është përllogaritur si më poshtë: **per percaktimin e fuqise punetore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të referencës, në preventivin:** :“Supervizion punimesh për objektin: Përmirësim i efikasitetit të energjisë dhe implementim të paneleve fotovoltaike për shoqërinë Durrës ”

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje 3 muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të **vlefshme (ose ekuivalente)** për objektin që prokurohet, si më poshtë:

-Çertifikatë SSH EN ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

-Çertifikatë SSH EN ISO 14001-2026 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

-Çertifikatë SSH EN ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar

-Çertifikatë SSH EN ISO 27001-2022 “Sistemit i menaxhimit të sigurisë së informacionit”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shenim: *Per çertifikatat e mesiperme operatorët ekonomik ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto çertifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto çertifikata janë unifikuar nga kjo Drejtoria.*

Të gjitha çertifikatat e mesipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mesipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik në të cilët përcaktohet:“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale;**...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet

ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

- **Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.
- **Certifikatë ISO 14001:2026** “Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit” mundëson që shoqëria të punojë me standarte e ruajtjes së mjedisit si dhe mundëson implikimin në mjedis, identifikimin e riskut dhe mundësive të ndikimit në mjedisin, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin që shoqëria ka për ruajtjen e mjedisit gjatë kryesjes së punimeve, duke garantuar një kontrollin e punimeve për sa i takon ruajtjes së mjedisit
- **Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose **certifikatë e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023**, mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.

- Çertifikatë **ISO 27001-2022** “Sistemit i menaxhimit te sigurise se informacionit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. mundëson që çdo shoqëri të mbroje sistemin e menaxhimit dhe te sigurise se informacionit per sa i takon punimeve.
- Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatoret ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj çertifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të kete ne pronesi ose me qera mjetet topografike që do shërbejnë për ofrimin e kontrollit te punimeve dhe shërbimit të mbikqyrjes, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- 1 (nje) Pajisje GPS
- 1 (nje) Total station

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:

Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit- blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Per pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

Në rastet e bashkimit të operatorëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

SHENIM: Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë domosdoshmerisht në përputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kesaj VKM. Kjo kerkese bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.

Të gjitha ofertat që do të jene me vlere me të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, do të refuzohen.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), Udhëzimit Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.